



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2091/12 Prot.

Patos, më 12.08/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 GUSHT 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Plani Vendor i Emergjencave Civile 2024-2030”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës nr. 2091 prot., datë 08.07.2025 të Drejtorisë së Projekteve dhe Emergjencave Civile.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues të bashkisë Patos, , rreth 46 pjesëmarrës (banorë, përfaqësues të shoqërisë civile, biznese, kryetarë të fshatrave etj)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba- përshëndetje të



Znj. Refaela Xeba
Dëgjese publike me temë:

**“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

gjithëve! Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë dëgjese publike! Tema e kësaj dëgjese

është Plani Vendor i Emergjencave Civile 2024-2030 dhe në fillim do të dëgjojmë njëher ekzekutivin me prezantimin e materialit dhe më pas nëse keni ndonjë ide, sugjerim apo koment ju ftoj ti propozoni që më pas t'i propozojmë në planin final.

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- përshëndetje të gjithëve! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë e kësaj dëgjese publike. Më bëhet qefi që në këtë sezon të vështirë për emergjencat civile ndërgjegjësimi është rritur dhe ju kërkoj të gjithëve që ne të vazhdojmë të bëjmë kujdes në këtë sezon të nxehtë të stinës së verës.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Përgjegjës i Emergjencave Civile në bashkië Patos, z. Arben Shpërdheja- përshëndetje! Sot kemi dëgjese për Planin e Emergjencave Civile 2024-2030 dhe ky është në kuadër të miratimit të dokumentave strategjik ku qarku i Fierit është në fazën pilot.



**Përgjegjës i Emergjencave Civile në
bashkië Patos
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Kemi kaluar dy fazat e para dhe me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 38 datë 30.06.2023 kemi miratuar Raportin e vlerësimit të Riskut, me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. 91 datë 12.12.2024 kemi miratuar Strategjinë për Zvogëlimin e Riskut dhe sot jemi mbledhur për Plani e Emergjencave Civile 2024-2030. Të gjithë këto dokumenta janë hartuar nga një grup i madh ekspertësh. Këtë dokument sot e kryeson zv/ Kryetarja e bashkisë si dhe çdo drejtori e ekzekutivit është pjesëtare në këtë plan, si edhe administratorët e njësive në

Ruzhdië dhe Zharrez. Kemi disa grupe pune të ndryshëm që kanë kontribuar në këtë plan. Në fillim të dokumentit kemi tabelë përmbledhëse ku kemi kuadrin ligjor të Strategjisë Kombëtare të Emergjencave Civile, kemi kuadrin institucional të dokumentave për mbrojtjen civile, qëllimin dhe objektivat e planeve vendore në bashkinë Patos. Parimi dhe funksionimi i planeve vendore të emergjencave civile lidhen me parashikueshmërinë dhe vendosshmërinë, vendimarrjen, lidhshmërinë, informacionin, bashkëpunimi me grupet e interesit. Një falenderim të veçantë për kryetarët e fshatrave që janë ndihur gjithmonë në çdo zonë, për policinë e shtetit që na ka mbështetur në të gjithë kohët dhe në veçanti prefektura që në zjarrin e fundit që patëm na mundësuan edhe ndërhyrjen nga ajri. Sistemi i mbrojtjes civile në nivel qendror dhe në nivel qarku dhe bashkie. Këto sisteme kalojnë në katër hapa. Kemi parandalim dhe lehtësim, gatitshmërinë, informacion dhe ndërgjegjësim publik ku janë shpërndarë në të gjithë njësinë Ruzhdië dhe fshatrat që përfshin, fletëpalosje për ndërgjegjësimin. Gjithashtu edhe në njësinë administrative Zharrez dhe në fshatrat që përfshin. Masat e gatitshmërisë sidomos ndërhyrja e zjarrefikëses me gjithë ekipin. Qendra e koordinimit që është edhe qendra e prefekturës që vazhdon të jetë udhëheqëse e këtij plani. Qëllimi kryesor është përgjigjja, aktivizim të përgjigjes ndaj situatave emergjente. Kemi raporte 4 orarëshe për zonat me rrezik të lartë dhe temperaturat. Kemi edhe aktivizimin për daljen nga situata. Plani Vendor i Emergjencave Civile synon pikë së pari të mbrojë jetët e njerëzve, të garantojë siguri, mirëqënien e banorëve gjatë emergjencave dhe fatkeqësive. Këtu kemi theksuar pronën, infrastrukturën, gjënë e gjallë, trashëgiminë kulturore, komunitetin dhe mjedisin. Plani ka si objektiv madhor rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit për të përballuar emergjencat dhe fatkeqësitë si dhe garantimin e rimëkëmbjes së tyre pas fatkeqësisë. Bashkia Patos me qëllim hartimin e këtij dokumenti sipas kërkesës së ligjit 45/2019 datë 18.07.2019 për Mbrojtjen Civile miratoi urdhrin me nr. 12 datë 24.01.2024 ndryshuar me urdhrin me nr. 52 datë 13.08.2024 "Për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik në nivel bashkie" për procesin e hartimit të dokumentit në nivel strategjik dhe zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë dhe planit vendor në nivel bashkie. Në këtë dokument grupi teknik në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u mbështet nga kompania konsulente në kuadër të UNDP. Gjatë periudhës së punës së grupit teknik u grumbulluan të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me zjarret në natyrë, rrëshkitjet e tokës, ndotjet teknologjike dhe industriale etj. U bë studim i të gjithë zonave me risk të shtuar duke pyetur komunitetet, bizneset dhe grupet e interesit. U zhvilluan takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësor. Ky dokument u hartua mbështetur në të dhënat e mbledhura. U zhvilluan disa dëgjesa publike për konsultimin e planit. Në këto dëgjesa u ftuan të merrnin pjesë komuniteti lokal, biznese dhe

grupe interesi duke siguruar një gjithëpërfshirje të plotë dhe të gjithëanshme. Dëgjuesat publike ndihmuan në diskutimin dhe përmirësimin e dokumentit ndaj kërkoj edhe sot të jeni të gatshëm për të diskutuar. Për të zbuluar një qasje në nivel rajonal u organizuan takime ndërmjet kryetarëve të bashkive të qarkut Fier. Synimi ishte integrimi për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe politikat dhe planet rajonale duke siguruar harmonizimin e strategjisë vendore. Dokumenti do të shërbejë si një udhërrëfyes kyç për planifikimin e zhvillimit urban. Ky integrim do të sigurojë që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë do të marrë në konsideratë rreziqet natyrore dhe mjedisore. Ky dokument është thelbësor për përmirësimin e bashkisë për të ruajtur nga fatkeqësitë, por në përputhje me kërkesat e ligjit ai duhet të rishikohet dhe përmirësohet në vazhdimësi për ta përshatur me ndryshimet e mundshme dhe sfidat që kanosen. Si përfundim grupi teknik vlerëson se ky dokument është i rëndësishëm dhe shumë i vlefshëm dhe e prezanton atë për ta diskutuar përfundimisht për ta miratuar në seancën e ardhshme në Këshillin Bashkiak.

Përgjegjës i Emergjencave Civile në Prefekturën Fier, z. Kreshnik Ymeraj– Përsëndetje! Unë do të doja të shtoja diçka nga ana formale lidhur me planin pasi ju përmendët periudhën 2024-2030. Ju sugjeroj që ta shikoni edhe njëherë këtë vendim pasi plani emergjencave i parë edhe nga ana e ekspertëve sugjerohet të rishikohet një herë në 3 vjet dhe periudha duhet të jetë 2025-2028. Pra të gjithë planet duhet të rishikohen një herë në 3 vjet. Kjo është më shumë për formalizëm. Unë jam njohur edhe me dokumentin tuaj dhe do i sugjeroja ekzekutivit që plani të mos konsiderohet si një plan i thjeshtë pasi është një dokument shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjithë territorit të bashkisë Patos.



**Përgjegjës i Emergjencave Civile në bashkië Patos
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Përgjegjës i Emergjencave Civile, z. Arben Shpërdheja– Ju falenderoj për sugjerimin dhe periudha e Planit do të rishikohet sipas sugjerimit tuaj. Lidhur me rëndësinë e Planit Vendor të Emergjencave Civile dua të theksoj që rëndësia e këtij plani duket edhe nga pjesëmarrja dhe

rëndësia që kolegët tanë i japin pasi ky plan i shërben shumë drejtorive dhe është një plan gjithëpërfshirës.



**Përgjegjës i Emergjencave Civile në
bashkië Patos
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Përfaqësuese e Kryqit të Kuq, dega Patos, znj. Drita Hyseni– përshëndetje! Unë kam një pyetje lidhur me trajnimet. Ju si bashki sa persona keni trajnuar lidhur me çështjet e Emergjencave Civile? Pra sa pjesë e stafit kanë marrë trajnim lidhur me çështje të ndryshme të Emergjencave Civile, siç ëhstë edhe zjarri?



**Përfaqësuese e Kryqit të Kuq, dega
Patos
znj. Drita Hyseni**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Përgjegjës i Emergjencave Civile, z. Arben Shpërdheja– e gjithë pjesa e stafit është e btrajnuar lidhur me emergjencat që mund të na kanosen. Ne kemi bërë edhe një nkalendar të trajnimeve të cilin nuk e vendosëm dot në funksion gjatë kësaj periudhe, por me fillimin e shtatorit kur shkollat, çerdhet, kopshtet të fillojnë do të fillojmë edhe me zbatimin e



**Përgjegjës i Emergjencave Civile
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

kalendarit të trajnimeve pasi është e nevojshme. Duhet edhe ti pajisim edhe me certifikatë lidhur me trajnimet në mënyrë që gjithçka të jetë korrekte nga ana formale.

Përfaqësues i Policisë së Shtetit Patos, z. Ilir Korçari- Përshëndetje! Unë kisha për të shtuar diçka. Fillimisht unë ju falenderoj të gjithëve lidhur me situatat e zjarreve pasi është



**Përfaqësues i Policisë së Shtetit Patos
z. Ilir Korçari**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

bërë një punë e mirë në menaxhimin dhe shuarjen e tyre. Unë mendoj që duhet pak më shumë bashkëpunim në lidhje me kryetarët e fshatrave dhe administratorët pasi duhet të jemi të kujdesshëm në shkëmbimin e informacionit për situatën e zjarrit në territorin e bashkisë. Duhet që secili prej nesh të jetë i kujdesshëm në dhënien e deklaratave pasi duhet të jenë persona të autorizuar nga titullari për të dhënë këtë lloj deklarate. Jo çdokush mund të jap deklarate lidhur me situatat të tilla. Ndaj kërkoj bashkëpunim nga administratorët dhe kryetarët e fshatrave lidhur me këtë situatë duke mos dhënë deklarata të tilla të paautorizuara.

Përgjegjës i Emergjencave Civile, z. Arben Shpërdheja- keni të drejtë lidhur me këtë situatë. Administratorët e njësive janë treguar bashkëpunues lidhur me këto situata. I kemi edhe pjesëmarrës në këtë dëgjese dhe mkund ta diskutojmë këtë pjesë.



**Përgjegjës i Emergjencave Civile
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Administrator i njësisë administrative Zharrëz, z. Riza Hoxha- Përshëndetje! Të gjithë kryetarët e fshatrave dhe policia kanë qenë bashkëpunues. Në njësinë Zharrëz situata e

zjarreve ka qenë më e qetë dhe jemi munduar ta menaxhojmë. Për sa i përket deklaratave secili duhet të jetë përgjegjës për këtë pjesë.



**Administrator i njësisë
administrative Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Kryetar i fshatit Gjynoqarë, z. Nuri Gllava- lidhur me deklaratat edhe unë kam dhënë një deklarat në media, por jam treguar i kujdesshëm në dhënien e ninformacioneve duke marrë parasysh që mediat e ekzagjerojnë situatën. Unë i falenderoj të gjithë punonjësit e bashkisë, policinë, prefekturën dhe çdo aktorë tjetër të ardhur në ndihmë. Situatat e tilla sjellin dhe median në terren dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm ku japim informacione.



**Kryetar i fshatit Gjynoqarë
z. Nuri Gllava**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Përfaqësues i biznesit, z. Shkëlqim Mykaj- edhe ne si biznese kemi përgjegjësi në këto situata dhe e mira është që të kemi njerëz të trajnuar për këto situata dhe njerëz të



**Përfaqësues i biznesit
z. Shkëlqim Mykaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

ndërgjegjësuar. Njërëzit e trajnuar nga ana e emergjencave civile janë shumë të domosdoshëm.

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Unë ju falenderoj për të gjitha komentet dhe sugjerimet tuaja. Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar e deklarojmë të mbyllur këtë dëgjese publike. Ju faleminderit!



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Vendor i Emergjencave Civile
2024-2030”**

Gusht 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba